



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0009886-1/25 dt. 26.02.2025

Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 37

Koha: 26.02.2025 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shoshollı Musa, Hysen Muzliukaj, Muhamed Hoti dhe Xhylljeta Imeri

Drejtoret e Drejtive

Mungoi: Erseka Barani

Mbledhjen e hapi dhe kryesoit Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komitetetve të përherershme dhe komitetetve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komitetetve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 37-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raport finanziar për periudhën janar-dhjetor 2024

Rendi i ditës u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur Raportin finansiar për periudhën janar-dhjetor 2024, theksoi se Raporti për seancën e Kuvendit do të dorëzohet me përmirësim në tabelën 2.

Në vazhdim Kryesuesja hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Te të hyrat vetanake, realizimi është 96.91%, realisht është mirë, nuk është keq. Te tabela numër një, sipas drejtorive, grumbullimi i të hyrave, është i mirë edhe për ekzekutivin, që secili e sheh veten se ku është, domethënë realizimin sipas planit që e kanë paraparë vetë. Te disa drejtori ka mundësi me u korrigju, me u përmirësu, unë kisha me cikë kështu te Drejtoria për Buxhet dhe Financa, meqenëse sipas planit këta nuk janë keq, janë 98% mirëpo kjo nuk është e kënaqshme, këtu pak ka ndiku edhe ai manevrimi që u bë rreth tatimit në pronë, jo po ndryshohet shkalla, jo s'po ndryshohet, ka krijuar një huti se realisht u dashtë me u tejkalu. E pashë një tabelë aty te të hyrat e arkëtueshme diku afér dhjetë milionë janë obligime dhe, çka ndodh, s'merret kush me të. Dhjetë milionë janë obligime të qytetarëve që kanë obligim me i pagu kontributet, tatimet, dhe ky është një shqetësim edhe për ekzekutivin, duhet me gjetë një model, një metodë që të stimulohen diqysh edhe të thithen këto mjete, se veç po rritet borxhi. Te urbanizmi, është pak ma problem, ka mbetë nën obligime, por sa do që të jetë aktive kjo drejtori, nuk varet krejt prej saj, për shkak se varet prej gjendjes së tregut. Te kategoritë tjera, disa e kanë tejkalu. Te investimet kapitale është mirë, për shkak se 81% janë realizuar. Bartja e obligimeve është në nivel, nuk ka obligime të bartura pa kontroll, kurse ajo që po na përcjell rregullisht është çështja e ekzekutimit përmes përmbaruesve, prapë është një goditje, kjo është për shkak të pagave dhe mëditjeve, ajo kontrata e famshme e arsimit, e dëgjova drejtorin e Asociacionit që tha se nëse vazhdon kështu komunat do t'ë do të hyjnë në kolaps.

Xhylljeta Imeri: Unë së pari do të rikërkoj dhe nuk e di pse nuk po vendoset kurrë krahasimi me vitin paraprak, e kam bërë këtë kërkesë vazhdimisht, po kalon mandati dhe ende nuk është realizuar, nuk e di për çfarë arsy. Do të vazhdoj tek raporti finansiar, siç e ceku parafolësi im që inkasimi i të hyrave vetanake është shumë i mirë, 96% është pozitiv dhe është e arritshme, si arritje mund të konsiderohet. Disa drejtori e kishin tejkalu planifikimin, disa jo. Por, do të ndalem tek investimet kapitale, realisht nuk janë 81%, duke marrë parasysh përmbaruesit, se këtu po mblidhen edhe ato që janë shpencnime të rregulla dhë të përmbaruesit, realisht në bazë të të dhënave 49% janë investime reale, por këtu nuk e vë në faj as ekzekutivin, se këto kanë qenë përpara dhe do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, po këtu humb, është minus edhe për ekzekutivin, po edhe për qytetarët, se nc pësojmë prej këtyre. Për shembull, mos investimi në Gjimnazin "Frang Bardhi", mos investimi i aneksit në shkollën "Aziz Sylemani", të cilat ju kanë marrë të hollat, madje shkollës së muzikës, është për keqardhje se çka do të ndodhë për vitin 2025, kur për vitin 2025 janë planifikuar objekte tjera, investime tjera, çka do të ndodhë me këto? Kjo është dilema ime.

Hysen Muzliukaj: Te krahasimi i inkasimit të të hyrave vetanake, mendoj se është trik, te të hyrat vetanake janë plotësuar krejt në rubrikën në fund dënimet e policisë, 371.000 €, 110.000 € prej gjobave nga gjykata dhe agjensioni i pyjeve. Kjo realisht është hera e parë që vjen në një kësi formati, se kur bëhet komplet mbledhja, normal që e rrit përqindjen, 96.91 %, kjo s'ish dashtë me qenë kështu, këtu tash sa e kemi planifikimin që kemi pritë prej tyre, nuk e kemi rubrikën, këto zakonisht janë hi tek zhvillimi ekonomik në të kaluarën,

por për arsy që me dalë përqindja ma e mirë, nuk është në rregull kjo tabelë. Unë jam jurist, por po flas si ekonomist, krahasimi i të hyrave nuk bën me qenë kështu, se nëse themi krahasimi i të hyrave vetanake me planifikim sipas drcjtorive, ku e kemi planifikimin që e kemi pritë prej këtyre gjobave. Kjo nuk është kështu, nuk matet pasqyra kështu, duhet të përmirësohet, kjo të hyjë në konkluzion, të përmirësohet, se në momentin që janë këtu katërqind e gati gjysmë milioni, normal që përqindja neve na del 96.91, por kjo nuk është pasqyrë realc. Zakonisht po bëhem i pak tē tepërt tu c lyp vazhdimisht reportin e detajuar të përmbaruesit privat. Është hera c tretë mc radhë që po e kérkoj, le të bashkëngjitet, ky raport edhe këto përmirësimet që u cekën. KPF-ja është thirrë qe një javë, ndërsa sot të thuhet diku në tabelën 2 është një gabim, kjo është jo serioze, nuk paraqet qëndrim serioz tē KPF-së, aq më tepër kur nesër është mbledhja e Kuvendit. Ky raport edhe tabela që e thashë, plasohen diku, na e mashtrojmë veten se në vitin tjetër prapë kemi me u ballasaquar, çka nëse ka gjoba më pak tē policisë, na nuk duhet me u matë me këtë punë, bie përqindja, edhe këtu ka me ra përqindja në total.

Muhamed Hoti: Meqenëse e kérkova fjalën, edhe unë kam hamendësimet e mijë, më saktësisht aty ku iu është dhënë mundësia juve që tē qeverisni me premtimet në investime direkt kapitale. Cila është arsyja kur e paraqitni para neve një investim kapital ju para neve e keni paraqitë njëfarë raporti, me tē cilën shumicën e vlerave t'i ka marrë përmbaruesi. Në aspektin ekonomik ti po paraqitesh me një vlerë 81% tē totalit të investimeve kapitale. Pe marr një shembull tē thjeshtë meqenëse është drejtori Elvis këtu, Drejtori e ka bë një investim, shpenzim i rregullt diku vlera 11.800 € për vitin 2024, veç ktheje pak në retro në vitin 2023 unë e kam bërë një analizë që investimi për parkun panoramik ka me kushtuar diku vlera 100.000 euro. A është ky keqplanifikim në bashkëpunim me Drejtorinë c Financave, apo keqmenaxhim i drejtorisë së caktuar me paranë. Tash kjo vlera 37.000 eurove prej nga ka ardhë që i ka marrë përmbaruesi, e zgjata duke dashtë me e bë sa më lehtë pyetjen dhe me e sqaru.

Elvis Feka: Realiteti qëndron që në 2023 janë realizuar 100.000 euro investime në Ballkonin Panoramik, që është realizuar 100% pjesa e bashkëfinancimit tonë. Në pjesën e këtij projekti që ka qenë marrëveshje bashkëfinancimi me MZHR-në dhe në marrëveshjen e bashkëfinancimit, në rast se nuk realizohen krejt punët brenda vitit fiskal, detyrohemë na si komunë me i bartë edhe pjesën e ministrisë, pjesën e pagesës së mbetur. Kësisoj nc jemi detyruar mc planifikuar në 2024 edhe pjesën e mbetur tē projektit i cili ka mbetë pa u realizu. Kësisoj kompania e cila ka pas me realizu projektin nuk ka arrit në vitin 2024 me e përbushë krejt, ka arrit veç 11 mijë euro me kry punë brenda marrëveshjes. Brenda kësaj marrëveshjeje kompanisë i ka skadu kontrata dhe kësisoj mjetet që kanë mbetë kanë shku në pagesë tē urdhëravc përmbanimorë, përndrysht po mendoj procedura e kësaj është gjithçka në rregull.

Kryesucsja Vesa Broja: Kësaj tabele i mungon pjesa në vazhdim ku thuhet se cilat janë shku me përmbarues, është e vërtetë edhe unë e kam bo tē njëjtën pyetje dhe tē njëjtën kérkesë kur kam qenë në mandatin e kaluar si anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa. Tash unë juve po ju them që si e keni marrë materialin dhe e keni këqyrë, është dashtë me ma dërgu një e-mail, se po ju kallëzoj sinqerisht që nuk i kam vërejt këto detaje, kështu që kérkesa është shumë e qartë, me ju bashkëngjité cilat kanë shku me përmbarues, cilat kanë shku me shpenzim tē rregullt. Kush është që tē miratohet reporti financiar për vitin 2024 me plotësimet që u cekën, nuk po ju premtoj me krejt plotësimet, se ncsër është seanca e

Kuvendit edhe drejtoresha nuk është sot gjatë tërë ditës këtu, me zyrtarë kemi me komunikuar me i shtu ato çka ne si KPF kena kërku. Kërkesa decidive e Hysenit ke me i shtu te investimet kapitale cilat janë shku me përmbarues, cilat janë pagesa të rregullta të investimeve kapitale.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Raportin finansiar për vitin 2024 me konkluzionin që raportit t'i bashkangjitet lista e pagesave të ekzekutuara sipas procedurave përmbarimore nga Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit deri më dt. 31.12.2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Raportin finansiar për periudhën janar-dhjetor 2024. Komiteti për Politikë dhe Financa kërkon nga ekzekutivi i Komunës që raportit t'i bashkangjitet lista e pagesave të ekzekutuara sipas procedurave përmbarimore nga Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit deri më dt. 31.12.2024. Raporti finansiar për periudhën janar-dhjetor 2024 i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:40 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

